



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 108 Prot

Tiranë, më 05, 07, 2011

VENDIM Nr. 167, dt. 05.07.2011

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 05.07.2011, mbasi shqyrtoi "Kërkesën për miratim sondazhi arkeologjik në sheshin e ndërtimit në pronë të Familjes Fatmir Guzia për objektin "Godinë banimi dhe shërbimi 2-3-4-5-6 kate+papafingo mbi tokë dhe 1 kat nën tokë garazh", Lagjja Nr. 6, Rruga "Hajdar Shameti", zona arkeologjike "B"Durrës - Subjekti "IKONA KO" sh.p.k,


VENDOSI:

- I. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës, të kryejë sondazhin arkeologjik në sheshin e ndërtimit në adresën e mësipërme.
- II. Subjekti "IKONA KO" sh.p.k, të lidhë kontratën dypalëshe me Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik për kryerjen e sondazhit arkeologjik.
- III. Raporti i sondazheve arkeologjike të paraqitet për miratim në mbledhjen e radhës të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.
Sondazhet të qëndrojnë të paprekura deri në marrjen e miratimit me shkrim nga KKA.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

SUZANA TURKU

ZV. MINISTRE



SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK